



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 465/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e subjektit politik Aleanca Kosova e Re

ARSYETIM

Me date 12.12.2010 PZAP ka pranuar një ankese nga subjekti politik AKR, ne te cilën pretendohet se aktivistet e subjektit politik AAK me date 12.12.2010 në qendrën e votimit Shkollën “Mazllum Kpuska” në Gjakovë, kanë shpërndarë vizitkarta të këtij subjekti politik.

Ne mbështetje te pretendimeve, parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b)një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

Duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura, PZAP vlerëson se ankesa e AKR-së është e parregullt për shkakun se ka mungesë të provave për t'u bindur se aktivistët e AAK-së kanë shkaktuar parregullsi te procesit zgjedhor. Për me tepër parashtuesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë prove si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Prandaj për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 465/2010 më datën 13.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrëm Shala**

